

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, Janar – Korrik 2021

Publikime Profesionale

- Financial Times - Makineritë e të dhënave: Siguruesit po përdorin Inteligjencën Artificiale për të riformtuar industrinë
- IOSCO publikon rezultatet e ekzhaminimit të sjelljes së Fondeve të Tregtuara me Këmbim, EFT, gjatë testeve të tregut të shkaktuara nga COVID-19
- Journal of Risk Management in Financial Institutions - Volumi 14, Nr. 3
- OECD publikon - “Vlerësimi i instrumenteve dhe mekanizmave financiarë të përzier”

Informacione Ndërkombëtare

- Kroaci
- Qipro
- Rumani
- Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar - korrik 2021


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-korrik 2021 kapën vlerën 10,936 milionë lekë, ose 18.62% më shumë se në periudhën janar-korrik 2020. Gjatë periudhës janar-korrik 2021, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 601,474 me një rritje prej 14.71% krahasuar me periudhën janar-korrik 2020.

Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.54 % të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 7.25%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 41.99% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 58.01% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-korrik 2021, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 4,245 milionë lekë, ose 6.99% më pak se në periudhën janar-korrik 2020.

Gjatë periudhës janar-korrik 2021, dëmet e paguara bruto të sigurimit motorik kapën vlerën 2,386 milionë lekë duke pësuar një rritje me rreth 44.53% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Struktura e tregut të sigurimeve, janar - korrik 2021 (Në %)



Gjatë periudhës janar-korrik 2021, dëmet e paguara bruto të sigurimit motorik kapën vlerën 2,386 milionë lekë duke pësuar një rritje me rreth 44.53% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Makineritë e të dhënave: Siguruesit po përdorin Inteligjencën Artificiale për të riformuar industrinë

<https://www.ft.com/>



Grupet në industrinë e sigurimeve po ndërtojnë profile të hollësishme të klientëve për t'i informuar ata për çmimet, duke u përpjekur të ndikojnë edhe në sjelljen e tyre. Inteligjenca Artificiale u lejon siguruesve të prodhojnë profile shumë të individualizuara të rrezikut të secilit klient dhe t'i përditësojnë këto profile në kohë reale.

Artikulli është publikuar në “*Financial Times*” në 16 gusht 2021. Ai përshkruan se si po ndryshon industria e sigurimeve në nivel global me përdorimin e Inteligjencës Artificiale. Në disa pjesë të tregut të sigurimeve, Inteligjenca Artificiale po përdoret për të rafinuar ose zëvendësuar modelin tradicional të një primi vjetor, duke krijuar kontrata që ndikohen nga faktorë që përfshijnë edhe sjelljen e klientit. Në disa raste, siguruesit po e përdorin Inteligjencën Artificiale për të vendosur nëse duan të marrin një klient apo nuk duan të përfshihen në marrëdhënie biznesi me të.

Artikulli përshkruan se si në teori, një aplikim i tillë mund të krijojë mundësinë që klientët të paguajnë një çmim më të drejtë për rrezikun e tyre individual, dhe siguruesit të jenë më të aftë të parashikojnë humbjet. Disa sigurues thonë se kjo gjithashtu u jep atyre më shumë mundësi për të ndikuar në sjelljen dhe madje edhe për të parandaluar që dëmtimet të mos ndodhin. Më tej artikulli paraqet shqetësimet e ekspertëve të Inteligjencës Artificiale lidhur me pasojat e përdorimit të të dhënave shëndetësore të individëve nga makineritë për të llogaritur primet e sigurimeve shëndetësore. Kjo, druajnë ekspertët, mund të bëjë që në përlllogaritjet e primeve të zërë vend këndvështrimi i shëndetit jo si mirëqenie njerëzore, por si diçka e bazuar në objektiva të nxitura nga kostoja. Artikulli përshkruan edhe debate të tjera etike lidhur me përdorimin e Inteligjencës Artificiale.

IOSCO publikon rezultatet e ekzaminimit të sjelljes ETF (Fondeve të Tregtuara me Këmbim) gjatë testeve të tregut të shkaktuara nga COVID-19

<https://www.iosco.org>

Bordi i Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Titujve (IOSCO) publikoi një informacion lidhur me sjelljen e Fondeve të Tregtuara me Këmbim (*Exchange Traded Funds, ETF*) gjatë streseve të tregut të shkaktuara nga COVID-19, duke u bazuar në të dhënat e tregut dhe vëzhgimet e mbledhura gjatë gjysmës së parë të vitit 2020. Burimet e informacionit përfshijnë, ndër të tjera:

- Analizën e të dhënave të përpiluara nga një grup kryesor kërkimor i Komitetit të Menaxhimit të Investimeve të IOSCO (C5);
- Përgjigjet e një sondazhi nga anëtarët e C5; dhe
- Përgjigjet e një anketimi të ndërtuar nga vetë tregu me pjesëmarrjen e tyre.

Raporti rishikon funksionimin dhe aktivitetet e tregjeve parësore dhe dytësore të ETF-ve gjatë kësaj periudhe. Në veçanti, ai eksploron ndikimin e stresit në strukturën dhe funksionimin e ETF-ve dhe shkaqet e ndryshimeve në çmime midis çmimeve të tregut sekondar të ETF-ve me të ardhura fikse dhe vlerave të tyre neto të aktiveve (NAV). Ai gjithashtu përshkruan disa rrethana sfiduese për disa ETF të bazuara në derivate.

Në përgjithësi, bazuar në informacionin aktual, nuk tregohet për ndonjë rrezik apo brishtësi të rëndësishme në strukturën e ETF-ve, megjithëse një nëngrup i ETF-ve patën përkohësisht sjellje të pazakonta tregtare. Analiza mund të shërbejë si udhëzuese kur IOSCO të marrë parasysh përmirësimet e ardhshme në rregullimin dhe udhëzimin lidhur me ETF.

IOSCO po vazhdon analizën më të gjerë të tregut të ETF-ve, gjatë vitit 2021, në përputhje me Programin e saj të Punës 2021-2022. Si pjesë e kësaj, konsulta të mëtejshme do të zhvillohen gjatë 2021 dhe gjysmës së parë të 2022.


Ashley Alder, Kryetar i Bordit të IOSCO-s tha: "Ky raport është një moment historik i rëndësishëm, ndërkohë që ne vazhdojmë punën tonë të vlerësimit pas streseve të tregut të shkaktuara nga COVID-19. Paqëndrueshmëria gjatë periudhës së COVID-19 ishte një test i rëndësishëm për rezistencën, për strukturat dhe operacionet ETF. Bazuar në gjetjet e përcaktuara në këtë raport, nuk është identifikuar asnjë rrezik i afërt i lidhur me këto vëzhgime nga perspektiva e stabilitetit rregullator ose financiar. Në fakt, dëshmitë empirike dhe reagimet e palëve të interesuara kanë tendencë të sugjerojnë se struktura ETF ishte relativisht elastike gjatë gjithë kohës."



OECD publikon “Vlerësimi i instrumenteve dhe mekanizmave financiarë të përzier”

(*Evaluating blended finance instruments and mechanisms*)

www.oecd.org



Ky punim jep një pasqyrë se si të vlerësohen instrumente dhe mekanizma të ndryshëm financiarë të përzier, duke përfshirë instrumentet e kapitalit neto, instrumentet e borxhit, kapitalin për humbjet e para (*first loss capital*), garancitë dhe sigurimet, bonot me ndikim në zhvillim, grante të bazuara në performancë, fonde të strukturuar dhe kreditë e sindikuara (*syndicated loans*).

Punimi është i strukturuar sipas pyetjeve më të rëndësishme dhe të zakonshme që vlerësuesit kërkojnë t'u përgjigjen, përfshirë (i) mënyrën për të matur mobilizimin e burimeve shtesë financiare dhe (ii) vlerësimin e rezultateve. Ai përshkruan metodat dhe mjetet më të përshtatshme për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve, duke theksuar avantazhet e disavantazhet e tyre, si edhe mundësitë e zbatimit.

Ky punim kontribuon në një kuptim të përbashkët të zgjedhjeve metodologjike, mundësive dhe sfidave në vlerësimin e secilit instrument dhe mekanizëm, veçanërisht për praktikuesit e ndërhyrjeve të përziera financiare. Ai ofron udhëzime praktike për zbatimin dhe forcimin e vlerësimeve në këtë fushë. Punimi do të jetë gjithashtu edhe një burim i vlefshëm për vlerësuesit përgjegjës për ndërhyrjet e përziera financiare të institucioneve të zhvillimit dypalësh dhe shumëpalësh.

“Vlerësimi i instrumenteve dhe mekanizmave financiarë të përzierë”

www.oecd.org

Përmbledhje kryesore e punimit – me shkurtime dhe redaktime

Shumë anëtarë të OECD DAC (*Development Assistance Committee* i OECD-së) tani po angazhohen në financa të përziera dhe numri i organizatave të reja që përfshihen po rritet çdo vit, si një mënyrë për të mobilizuar investime shtesë, e për të arritur qëllimet ambicioze të Axhendës 2030 dhe Marrëveshjes së Parisit për Klimën. Megjithatë, krahas nivelit të lartë të interesit për financa të përziera, ekziston njëfarë skepticizmi në lidhje me rolin e financave të përziera, rëndësinë dhe ndikimet në zhvillim.

Parimet e Financave të Përziera (2017) të ngritura nga Komiteti i Asistencës për Zhvillim i OECD-së (DAC), nxjerrin në pah nevojën për "Monitorimin e financave të përziera për transparencën dhe rezultatet". Në raportin e tij të vitit 2018, OECD gjithashtu theksoi nevojën për të krijuar një bazë të dhënash për operacionet e përziera të financave.


Përpjekjet e deritanishme janë përballur me një sërë sfidash. Një punim i OECD analizoi në mënyrë më të detajuar, duke theksuar: (i) Mungesën e një terminologjie të përbashkët për vlerësimin e financave të përziera; (ii) Mungesa e kuptimit të përbashkët të dimensioneve të ndryshme të shtesës, - akoma më pak të zhvillimit shtesë - dhe si duhet të vlerësohen këto; dhe (iii) Nevoja për më shumë qartësi se si instrumentet specifike dhe mekanizmat (kapitali, garancitë, huatë, etj.) duhet të vlerësohen.

Duke njohur përfitimet e një qasjeje të bashkërenduar për trajtimin e këtyre çështjeve, Rrjeti i OECD DAC për Vlerësimin e Zhvillimit (EvalNet) të cilët janë ekspertë të pavarur me përvoja të ndryshme vlerësimi, krijuan një Grup Pune për Vlerësimin e Financave të Përziera, në shkurt 2019. Objektivi i tij është të kontribuojë në përmirësimin e praktikës së vlerësimit në këtë fushë, bazuar mbi një kuptim të përbashkët të koncepteve dhe çështjeve. Në fund të fundit, qëllimi është të mbështesim përzierjen më efektive të operacioneve financiare për zhvillim të qëndrueshëm.

Puna e mbikëqyrur nga një Grup Koordinues i përbërë nga Danimarka, Gjermania, Norvegjia dhe Sekretariati OECD organizohet në tre drejtime pune:

1. Zhvillimi i një kuptimi të përbashkët të koncepteve dhe termave të ndryshëm të lidhur me financat e përziera, vlerësimi dhe përdorimi i tyre, përfshirë implikimet e këtyre përkufizimeve të ndryshme për bashkëpunimin e vlerësimit dhe zhvillimit;
2. Duke u bazuar në përkufizimet, qartësimi se si të vlerësohet shtesa e zhvillimit ose ndikimi në zhvillim (termat që përdoren aktualisht për të përshkruar kontributin e aktiviteteve të përziera financiare për zhvillimin) dhe shtesë financiare;
3. Zhvillimi i një të kuptuari të përbashkët se si të vlerësohen instrumentet dhe mekanizmat e ndryshëm financiarë të përziera.

Gjetjet e secilës pikë do të publikohen si një Dokument Punues i OECD. Ky punim paraqet rezultatet e grupit të tretë të punës.



HENRYSTEWART PUBLICATIONS

[REGISTER FOR UPDATES >](#)

HOME | ALL JOURNALS | FINANCE | MANAGEMENT | MARKETING | DIGITAL | REAI ESTATE / PROPERTY

Each volume of *Journal of Risk Management in Financial Institutions* consists of four 100-page issues, published both in print and online. Articles scheduled for Volume 14 are available to view on the [forthcoming content](#) page.

Volume 14 Number 3

- Editorial: The Global Core Indicators: A sustainability risk management and reporting framework**
Madelyn Antoncic, PhD, Senior Advisor to UNCTAD on SDG Reporting
- Practice papers**
 - Predicting sovereign credit ratings for portfolio stress testing**
Jonas de Oliveira Campino, Lead Strategist, Risk Management Specialist in the Office of Risk Management, Federico Galizia, Chief Risk Officer, Daniela Serrano, Economist and Frank Sperling, Unit Chief, The Inter-American Development Bank
- Developing practical mitigations for reputational risks: A case study from the UK insurance sector**
Matthew Connell, Director of Policy and Public Affairs, Chartered Insurance Institute

ABSTRACT ▾

ABSTRACT ▾

DETAILS

Call for articles
Call for Papers - Advances in ESG, Integration, Risk Management and Thematic Investing
Contact Us
Editorial Board
Forthcoming content

Revista “Menaxhimi i Riskut në Institucionet Financiare” (Journal of Risk Management in Financial Institutions) Volume 14, (2021) Numri 3

<https://www.henrystewartpublications.com/>

Ky numër përmban ndër të tjera edhe artikujt e mëposhtëm:

Editorial

“Treguesit kryesorë globalë – Qëndrueshmëria për menaxhimin e riskut dhe kuadrin e raportimit” - Madelyn Antoncic, PhD, Këshilltare e Lartë në UNCTAD për Raportimin e SDG.

“Parashikimi i vlerësimeve të kredisë sovraane për testimin e rezistencës së portofolit” - Jonas de Oliveira Campino, Specialist Drejtues i Menaxhimit të Rrezikut Strategjik në Zyrën e Menaxhimit të Riskut; Federico Galizia, Drejtor i Njesisë së Rrezikut; Daniela Serrano, Ekonomiste; Frank Sperling, Shef i Njesisë, Banka Ndër-Amerikane e Zhvillimit.


“Hartimi i praktikave zbutëse për rreziqet e reputacionit: Një rast studimi nga sektori i sigurimeve në Mbretërinë e Bashkuar” - Matthew Connell, Drejtor i Politikave dhe Çështjeve Publike, Instituti Chartered i Sigurimeve.

“Eliminimi i ndikimeve negative të rezultateve të Bazel IV duke rregulluar modelin e biznesit të një banke” - Martin Neisen, Partner, PricewaterhouseCoopers; Hermann Schulte-Mattler, Profesor, Universiteti i Shkencave dhe Arteve të Aplikuara në Dortmund, Gjermani.

“Evolucioni i menaxhimit të rrezikut, nga përputhshmëria me rrezikun në menaxhimin strategjik të rrezikut. Pjesa II: Evolucioni i riskut të ekzekutivit dhe të bordeve – ndryshimi i paradigmës - një analizë mbi sektorin bankar dhe të sigurimeve të Kanadasë” - Bogie Ozdemir, Konsulent për vizionin mbi riskun.

“Inteligenca artificiale e shpjegueshme: Një qasje e shpejtë globale” - Daniel Mayenberger, Drejtor Ekzekutiv i Produkteve Dixhitale dhe Intelgjencës Artificiale, JPMorgan Chase.

“Kultura e qeverisjes së rrezikut në institucionet financiare” - Paolo Agnese, Profesor i Asociuar i Bankës dhe Financave, UNINETTUNO - Universiteti Telematik Ndërkombëtar; Paolo Capuano, Profesor i Menaxhimit dhe Financave të Sigurimeve, Universiteti Sapienza i Romës.



Revista “Menaxhimi i Riskut në Institucionet Financiare”
(Journal of Risk Management in Financial Institutions)
Volume 14, (2021) Numri 3

<https://www.henrystewartpublications.com/>

“Hartimi i praktikave zbutëse për rreziqet e reputacionit: Një rast studimi nga sektori i sigurimeve në Mbretërinë e Bashkuar”

Matthew Connell, Drejtor i Politikave dhe Çështjeve Publike, Instituti Chartered i Sigurimeve.


Abstrakt:

Institucionet financiare gjithnjë e më shumë kanë nevojë për një kulturë integrale dhe të përhapur, veçanërisht përsa i përket rreziqeve dhe marrëdhënieve me palët e interesuara. Kjo kulturë udhëheq sjelljen dhe organizimin e korporatës. Gjatë ndërtimit të kësaj kulture pozitive ndaj rrezikut, institucionet financiare duhet të jenë protagonistë dhe jo spektatorë. Kjo do të thotë që qeverisja e rrezikut domosdoshmërisht duhet të përfshihet në proces.

Në këtë punim është analizuar rëndësia e menaxhimit të rrezikut në strukturën organizative të institucioneve financiare, duke marrë parasysh kalimin logjik nga kultura e rrezikut në qeverisjen e rrezikut. Punimi më pas shqyrton aspektet kryesore të qeverisjes së rrezikut dhe sesi janë analizuar ato në literaturën e kohëve të fundit, në mënyrë që të kuptohet lidhja e mundshme midis përfitimit të bankës dhe rrezikut. Punimi zbulon se literatura lidhur me qeverisjen është zhvilluar në mënyrë të konsiderueshme që nga shpërthimi i krizës financiare globale, duke çuar në zbatimin jo vetëm të paradigmeve teorike, por edhe të analizave empirike.

Hulumtimet sasiore në përgjithësi përdorin modele të regresionit të shumëfishtë - me ose pa efekte fikse - por disa teknika inovative të analizës janë përdorur për aspekte të veçanta të analizës siç është vlerësimi i disa variablave të caktuar. Rezultatet e rishikimit të literaturës tregojnë një prirje të përgjithshme drejt vëmendjes më të madhe nga institucionet financiare ndaj qeverisjes së rrezikut, e cila tenton të lidhet me një performancë më të mirë, edhe pse studimet mbi këtë temë nuk pajtohen gjithmonë.

Rëndësia e qeverisjes së mirëstrukturuar, efikase dhe efektive të rrezikut bankar, del si përfundim kyç, edhe pse kërkimi mbi modelet e mëtejshme të analizës së qeverisjes së rrezikut pritet të vijojë, veçanërisht në dritën e kontekstit të fundit ekonomik dhe financiar ndërkombëtar.



Revista “Menaxhimi i Riskut në Institucionet Financiare”
(Journal of Risk Management in Financial Institutions)
Volume 14, (2021) Numri 3

<https://www.henrystewartpublications.com/>

“Kultura e qeverisjes së rrezikut në institucionet financiare”


Paolo Agnese, Profesor i Asociuar i Bankës dhe Financave, UNINETTUNO - Universiteti Telematik Ndërkombëtar;
Paolo Capuano, Profesor i Menaxhimit dhe Financave të Sigurimeve, Universiteti Sapienza i Romës.

Abstrakt:

Pjesa e parë e këtij punimi shqyrton evolucionin e funksionit të rrezikut në përgjigje të: (i) shpalesjes së informacionit financiar që po bëhet gjithnjë e më shumë e bazuar në rrezik; (ii) nevojës në rritje për të optimizuar menaxhimin e kapitalit dhe përzierjen e biznesit për të rritur Normat e Kthimit nga Kapitali (ROE). Kornizat e optimizimit për të përcaktuar 'strategjitë' optimale të rrezikut duhet të përcaktohen nga funksioni i rrezikut, i cili tani është në thelbin e zbulimit financiar, teknologjisë dhe strategjisë.

Pjesa II shqyrton kompetencat e nevojshme që drejtuesit e rrezikut, në veçanti Drejtori i Menaxhimit të Rrezikut (CRO), të jetë efektiv dhe të udhëheqë evolucionin. Këto janë kompetenca analitike, dixhitale dhe strategjike. Për rolet drejtuese në financa, kontabilitet, funksione aktuariale dhe inxhinieri, është e njohur që kualifikimet profesionale, njohuritë dhe përvoja e avancuar e përmbajtjes kërkohen në mënyrë që udhëheqësit të jenë efektivë. Ne vërejmë se kjo shpesh nuk ndodh për drejtuesit e rrezikut bankar. Nuk është e pazakontë të shohësh një udhëheqës pa ekspertizë dhe përvojë specifike të rrezikut duke mbajtur role të larta ekzekutive të rrezikut, madje edhe CRO.

Rolet e CRO gjithashtu kanë lëvizshmëri të kufizuar në karrierë dhe mund të jenë ndalesa e fundit, duke e lidhur drejtuesin drejt daljes në pension. Ne shqyrtojmë shkaqet e mundshme, duke përfshirë arsyet historike, paragjykimet e njerëzve të brendshëm, paragjykimet njohëse dhe keqpërdorimin e pushtetit. Ne bëjmë sugjerime për përmirësime dhe hapjen e rrugës për brezin e ardhshëm të profesionistëve të rrezikut për të plotësuar rolet ekzekutive dhe të bordit dhe për të udhëhequr evolucionin e nevojshëm.



Revista “Menaxhimi i Riskut në Institucionet Financiare”
(Journal of Risk Management in Financial Institutions)
Volume 14, (2021) Numri 3

<https://www.henrystewartpublications.com/>

“Inteligjenca artificiale e shpjgueshme: Një qasje e shpejtë globale”


Daniel Mayenberger, Drejtor Ekzekutiv i Produkteve Dixhitale dhe Inteligjencës Artificiale, JPMorgan Chase

Abstrakt:

Vendimet në industrinë financiare po vendosen gjithnjë e më shumë në varësi të algoritmeve të Inteligjencës Artificiale dhe mësimit të makinerisë (AI/ML). Këto vendime përfshijnë linja të tëra biznesi dhe zinxhirë vlerash, përfshirë marketingun e klientëve, sigurimin e kredive, planifikimin financiar dhe të kapitalit, tregtimin algoritmik dhe ndërveprimin e automatizuar me klientët, veçanërisht *chatbots* dhe këshillat *robo*.

Megjithatë, algoritmet më të avancuara janë komplekse dhe disi të fshehta, pasi ato kërkojnë deri në qindra të dhëna hyrëse, të cilat më pas i nënshtrohen disa shtresave të përpunimit që nuk janë transparente. Një kompleksitet i tillë ngre nevojën për të shpjeguar IA dhe për të kuptuar se si këto algoritme arrijnë në një rezultat specifik dhe se si funksionojnë ato në përgjithësi. Aftësia shpjguese lokale identifikon përcaktuesit kryesorë të një prodhimi specifik, ndërsa aftësia shpjguese globale identifikon inputet që kanë ndikimin më të lartë në prodhimin për algoritmin në tërësi.

Ky punim paraqet një qasje sipas modelit njohës që ofron aftësi të shpjgimit lokal përmes kundërfakteve dhe, më e rëndësishmja, aftësisë globale të shpjgimit të shpejtë.



KROACI

www.xprimm.com

Sipas shifrave të publikuara në faqen zyrtare online nga Byroja Kroate e Sigurimeve (*Croatian Insurance Bureau, CIB*), vëllimi i primeve të shkruara bruto për gjashtëmujorin e parë të vitit 2021 u rrit me 13.13%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Të 15-të shoqëritë e sigurimit me bazë në Kroaci realizuan së bashku, në fund të gjashtëmujorit të parë, një vlerë prej 6.40 miliardë HRK ose rreth 855 milionë EUR.

Primet në sigurimin e Jo-Jetës u rritën me 13.29%, e shprehur në terma vjetore, duke arritur në 4.82 miliardë HRK, ndërsa primet e sigurimit të Jetës u rritën me 13.27% në terma vjetore, duke arritur 1.58 miliardë HRK.

QIPRO

www.xprimm.com

Sipas të dhënave nga Shoqata e Sigurimeve të Qipros, tregu i sigurimeve të Qipros arriti në 243 milionë EUR në fund të tremujorit të parë 2021. Tregu shënoi kështu një rritje me 0.5% në terma vjetore.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto nga segmenti i sigurimeve të Jo-Jetës arriti në 131.8 milionë euro, me një rënie prej -3% në terma vjetore. Ndërsa segmenti i sigurimit të Jetës realizoi një vëllim të primeve prej 110.9 milionë EUR, ose 5% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë.

Vlera e dëmeve të paguara bruto (pagesat dhe rezervat së bashku) u ulën me 22% në terma vjetore duke arritur në 103.8 milionë EUR, nga të cilat 51.5 milionë EUR lidheshin me dëme për sigurimin e Jetës, të cilat u ulën me -26% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Pagesat e dëmeve për sigurimet e Jo-Jetës arritën në 52.3 milionë EUR.

RUMANI

www.xprimm.com

Sipas raportit tremujor të publikuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, ASF, në Rumani, gjatë tremujorit të parë të vitit 2021, tregu rumun i sigurimeve arriti në 3.19 miliardë RON, ose rreth 648.7 milionë EUR, duke shënuar një rritje me rreth 8.2% në vit.

Tregu i sigurimeve të Jo-Jetës solli rreth 78% të vëllimit total të primeve të shkruara bruto. Sigurimi i Jo-Jetës mbetet kryesisht i dominuar nga sigurimet motorike, të cilat përfaqësojnë rreth 71% të vëllimit të primeve të shkruara bruto të Jo-Jetës dhe 56% të totalit të tregut.

Tregu i sigurimeve në Rumani karakterizohet nga një shkallë e mesme deri në një shkallë të lartë të përqendrimit. Kështu që në tremujorin e parë të 2021, afërsisht 89% e vëllimit të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto u realizua nga 10 nga 27 kompanitë e sigurimeve.

VENDET E EUROPËS QENDRORE DHE LINDORE

www.xprimm.com

Tregjet e sigurimeve të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL) e mbyllën tremujorin e parë të vitit 2021 me një vëllim prej 10.34 miliardë EUR prime të shkruara bruto. Kjo shifër shpreh rritje për 17 vende të këtij rajoni me rreth 4.66% e përlogaritur në terma vjetorë. Vetëm katër tregje të sigurimeve të këtij rajoni patën një dinamikë negative. Përmbledhja e të dhënave është bërë nga Xprimm.

Në të njëjtën kohë, gjatë tremujorit të parë të vitit 2021 siguresit e vendeve të EQL paguan kërkesat për dëmshpërblime me vlerë 5.46 milionë EUR, ose rreth 4.89% më pak se e njëjta periudhë e një viti më parë.

Vëllimin më të madh të primeve e zunë ato të realizuara në klasat e sigurimeve të Jo-Jetës duke realizuar rreth 7.24 miliardë EUR me një rritje prej rreth 4.77% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërsa sigurimet e Jetës realizuan 3.09 miliardë EUR nga 2.97 miliardë EUR që ishte kjo shifër gjatë tremujorit të parë të vitit 2020. Ndër klasat e sigurimit të Jo-Jetës vëllimin kryesor të primeve të shkruara bruto e realizuan:

- ✓ Sigurimi Kasko me 1.18 miliardë EUR
- ✓ Sigurimi motorik, TPL me 1.16 miliardë EUR
- ✓ Sigurimi pronës me 1.53 miliardë EUR

Tregjet më të mëdha të sigurimeve në rajon ishin Polonia me 36.6% të tregut, e ndjekur nga Republika Çeke me 16.5% dhe Hungaria me 9.6% të tregut.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al